



KOHA PËR MUNDËSI TË REJA PËR PROFESIONIN E AUDITUESIT LIGJOR

Të nderuar kolegë,

Prej më shumë se 25 vitesh kam qenë pjesë aktive e profesionit tonë si auditues, trajner dhe kontribues në zhvillimin e standardeve dhe trajnimeve të IEKA-s.

Nëse më besoni votën tuaj, do të përkushtohem që së bashku me **ju të hapim horizonte të reja për profesionin:**

- Do të lloj pranë autoriteteve përgjegjëse dhe donatorëve që drejtojnë reformën në fushën e raportimit financiar që **“misioni i rishikimit të pasqyrave financiare”** të bëhet detyrim ligjor për SME-të që nuk auditohen, duke hapur një treg të ri me vlerë 3–4 milionë euro në vit për audituesit ligjorë.
- Do të synoj që të forcoj pozicionin e organizatës tonë, duke e promovuar si më të përshtatshme dhe efektive në vend, për të mundësuar zbatimin e **Standardeve të Qëndrueshmërisë (Sustainability Reporting)**, duke i dhënë një rol kyç si në hartimin e kuadrit rregullator dhe institucional ashtu edhe në krijimin e programeve për rritjen e kapaciteteve për standardet dhe metodologjitë përkatëse.
- Do të punoj për **konsolidimin e funksionit të inspektimeve për sigurimin e cilësisë** në mënyrë që autoriteti dhe besueshmëria e Organizatës përballë institucioneve mbikëqyrëse të forcohet duke na siguruar më shumë autonomi në këtë drejtim

Besoj se së bashku mund të ndërtojmë një profesion më të fortë, më të respektuar dhe me më shumë perspektivë.

Është koha për të treguar maturi, reflektim, dhe bashkëpunim që energjitë dhe kohën e secilit ti shfrytëzojmë sa më mirë në dobi të organizatës dhe profesionit tonë.